



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/07/22

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga av. .N.SH, ndaj gjyqtarit L.XH, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 03.02.2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga av. N.SH ndaj gjyqtarit L.XH, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Avokati N.SH ka ushtruar ankesë ndaj gjyqtarit L.XH e cila është pranuar në kompetencë nga Autoriteti i Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 19.01.2022, për inicim të procedurës disiplinore. Me datë 27.01.2022 është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës për pranimin e ankesës nga parashtruesi.

Parashtruesi i ankesës av. N.SH ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtarit L.XH shkak të pretendimeve se, gjyqtari në çështjen gjyqësore lidhur me lëndën C.nr.3529/19 nuk ka caktuar seancë me kohë, pra nuk ka vepruar konform dispozitës së nenit 400 të Ligjit 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore, dhe me këtë, sipas parashtruesit, gjyqtari ka shkelur nenin 5 par.2 pika 2.7 të Ligjit Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit L.XH.

Autoriteti i kësaj Gjykate bazuar në faktet e çështjes ka gjetur se, nuk ka baza të arsyeshme për shkelje disiplinore lidhur me mosveprimet e gjyqtarit L.XH, në lëndën në të cilën është ankuar pala. Lidhur me pretendimin e palës ankuese, se gjyqtarja e rastit ka shkelur dispozitën e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.7 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, për shkak të mos caktimit të seancës me kohë dhe brenda një afati të arsyeshëm, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme për t'i vërtetuar pretendimet e ushtruesit të ankesës, sepse gjyqtari i rastit ka ndërmarr veprime

procedurale në drejtim të zgjidhjes së lëndës, ku ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, dhe pasi është kthyer përgjigjja në padi, lënda do të zgjidhet në bazë të radhës së pranimit, sepse lëndët me bazë të kontestit “anulim kontrate” hyjnë në kuadër të lëndëve të rregullta kontestimore, që procedohen sipas radhës së pranimit, në pajtim me Strategjinë dhe planin e Gjykatës për kryerjen e lëndëve të vjetra dhe atyre me prioritet ligjor siç janë: Kërkesat për Urdhër Mbrojtje, lëndët për çështje statusore dhe familjare, lëndët për konteste pune, pengim posedimi etj, dhe për këtë vlerëson se nuk është shkelur dispozita e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.7 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkuara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/07/22, me datë 03.02.2022

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë